

Tiranë, më datë 14 Qershor 2024

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“BUBBLES Car Wash” Sh.p.k,

Sot më datë 14 Qershor 2024, une i nënshkruari, Sidorela Muha, shtetase Shqiptare, lindur në Bersnik, Shqiperi, e bija e Vasil, e datëlindjes 30.06.1995 banues ne adresën Rruga Zyrihu, Ndertesa 25, H3, Kamez 1030 madhor me zotësi te plote juridike e për te vepruar, i identifikuar me ane te leternjoftimit me nr. 033165604 dhe nr personal J55630104A, në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, kam vendosur të krijoj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“BUBBLES Car Wash” Sh.p.k**, (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet.

**Kapitulli I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1
Forma e Shoqërisë**

- Shoqëria **“BUBBLES Car Wash” Sh.p.k**, është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 2
Emri i Shoqërisë**

Emri i Shoqërisë është **“BUBBLES Car Wash” Sh.p.k**.

**Neni 3
Objekti i shoqërisë**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Lavazh
- Makina me qera
- Parking

**Neni 4
Selia e Shoqërisë**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: **Rruga e Aeroportit, Artilerise, Nr 15, Nikël, Rinas, Krujë.**

Neni 5 Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.
2. Afati i aktivitetit të shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakëve) ose të mbyllet me akte ligjore.

Kapitulli II KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6 Kapitali themeltar

1. Kapitali i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Kapitali është i përbërë nga 1 (nje) kuote me vlerë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 7 Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre

Derdhja e kuotave të kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e mëposhtme:

1. z. **Sidorela Muha** ka derdhur në para shumën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 8 Kapitali sipas kontributeve

Kapitali sipas kontributeve të cituara:

1. z. **Sidorela Muha** zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit, e barabarte me 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

Neni 9 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë

1. Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
2. Administratori njofton per regjistrim, prane Qendres Kombëtare të Biznesit, vendimin per zmadhimine kapitalit.
3. Vendimi publikohet edhe ne faqen e internetit të Shoqërisë.
4. Zmadhimi i kapitalit behet efektiv ne datën e regjistrimit te realizimit te tij, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 10 Zmadhimi i kapitalit me aktive të Shoqërisë

1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë të zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
-

2. Pjesa e rezervave, që shkon pertej 1/10 se kapitalit të regjistruar, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohën në kapitalin fillestar.
3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.
4. Pjesë e kapitalit mund të shtohet cdo investim që do të bëhet në ardhmëri në emër të shqyrtimit të aspekteve materiale apo kontraktuale të shërbimit.

Neni 11 **Zvogëlimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë**

1. Asambleja e përgjithshme mund të reduktojë kapitalin themeltar.
2. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
3. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qëndres Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratorët.
4. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 12 **Transferimi i kapitalit dhe e drejta e parablerjes**

1. Kuotat e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. E drejta e parablerjes rezervohet në fillim për ortakët.
3. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara nga Ligji.

Neni 13 **Pasojat e kalimit të kuotave**

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË, ADMINISTRIMI,** **KONTROLI**

Neni 14 **Organi Vendimmarrës**

1. Shoqëria administrohet nga Administratori i cili emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.
 2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga ortakët e shoqërisë dhe emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.
-

Neni 15

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

Thirrja e Asamblese se Përgjithshme behet me kerkesen e nje ose me shume ortakeve dhe është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme.

1. percaktimin e politikave tregtare te Shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin dhe ose shkarkimin e administratorëve;
4. emerimin dhe ose shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabël të autorizuar;
5. percaktimin e shperblimeve per personat e permendur në pikat "3" dhe "4" të këtij neni;
6. mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarisë së shoqërisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
8. zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. autorizon perfaqësimin e Shoqërisë ne gjykatë dhe ne çështje të tjera ligjore;
11. riorganizimin e Shoqërisë;
12. miratimin e regullave procedurale te mbledhjeve te Asamblesë së Përgjithshme;
13. çështje te tjera te parashikuara nga ligji.

Neni 16

Administrimi

Shoqëria administrohet nga Administratori per nje mandat 5 vjecar, nga data e regjistrimit në QKB deri me perfudnim të 5 viteve kalendarike me te drejte ripërteritjeje dhe ka detyrimet si më poshtë.

1. Të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar legjislacionin përkatës, politikat tregtare apo strategjive të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 2. Të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
 3. Është përgjegjës për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentacionit dhe librave kontabel te Shoqërisë;
 4. Është përgjegjës të pergatise dhe nënshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarisë së shoqërisë dhe se bashku me propozimet per shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente perpara Asamblese se Përgjithshme per miratim;
 5. Të paralajmërojë ne kohën e duhur per rrethanat që kercënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
 6. Të kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te Shoqërisë, sipas parashikimeve ligjore në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 7. Të raportoje perpara Asamblese se Përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posame me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqërisë;
-

8. Të veprojë, personalisht ose duke i deleguar personave të tretë, lidhur me të gjitha procedurat për regjistrimin e Shoqërisë si person juridik pranë organit kompetent.
9. Ka përgjegjësinë e administrimit, të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të Shoqërisë duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe ekzekutimin e të gjitha akteve në emër dhe për llogari të Shoqërisë;
10. Të kryejë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 17

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

Administratori ka përgjegjësinë të kryejë detyra të percaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin me të mirë të Shoqërisë në interesin dhe përgjegjësit kundrejt Shoqërisë për do veprim që vjen në kundërshtim me ligjin, detyrat dhe shkel standardet profesionale të Shoqërisë.

Kapitulli IV

SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 18

Shpërndarja e fitimit

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakeve në raport me kuotat e zotëruara.

Kapitulli V

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 19

Shkaqet e prishjes së Shoqërisë

Shoqëria prishet:

1. kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
2. me vendim të asamblese së përgjithshme;
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. nëse nuk kryen veprimtari tregtarë për dy vjet;
5. me vendim të gjykatës;

Kapitulli VI

TË DREJTAT E ORTAKEVËVE, LEGJISLACIONI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 20

Pjesmarrja në shoqëri të tjera

Ortakët mund të vendosin lirisht pjesmarrjen në shoqëri të tjera dhe të fillojnë çdo lloj aktiviteti tjetër në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 21
Legjislacioni i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në Republikën e Shqipërisë ose dispozitat ligjore në vendet e huaja ku shoqëria kryern aktivitetet të perkohshëm ose të përhershëm.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve, osë ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, palët do të drejtohen Gëkatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane.

Kapitulli VI
DISPOZITA FINALE

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe.

Lexuar, pranuar dhe nënshkruar :

Themeluesi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

« BUBBLES Car Wash» Sh.p.k

Sidorela Muha
